#### DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
  2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

**EKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>4</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [**Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in**]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[**shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE**], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne [**vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [**vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit**].
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor** [**vendos emrin e Autoritetit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

## Shtojca 2.

*[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:**

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

**Shtojca 3.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njesi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

#### Shtojca 4.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
*[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 5.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

---

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

*b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*

*c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**SPECIFIKIMET TEKNIKE JANE TE PASQYRUARA NE SHTOJCEN BASHKELIDHUR DST.**

**Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**LOTI 1:” Blerje materiale ndërtimore”**

<b>Nr.</b>	<b>Artikulli</b>	<b>Specifikimet teknike</b>	<b>Njesia</b>
1	Rrjetë metalike për kafaze	Rrjetë tib gabion, fije çeliku inoksidabël, fije e shumëfishtë me thurje, me rombe me përmasa 4x4	m2
2	Kavo çeliku Ø 6mm	Kavo çeliku e galvanizuar, Ø6 mm. Përbërja çeliku.	ml
3	Kavo çeliku Ø 4mm	Kavo çeliku e galvanizuar, Ø4 mm. Përbërja çeliku.	ml
4	Morseta çeliku	Morseta çeliku kapëse që përdoren në shtrëngimin dhe fiksimin e kavove të çelikut. Për kavo me Ø6 mm	copë
5	Morseta çeliku	Morseta çeliku kapëse që përdoren në shtrëngimin dhe fiksimin e kavove të çelikut. Për kavo me Ø4 mm	copë
6	Tiranta inoksi	Tirant sy/sy. Material inoks për, 6mm.	copë
7	Rrjetë hijezimi	1 roll 100 M, mbrojtja 90%	ml

8	Profile hekuri 40x40x40, 6m	Profile çeliku spesor 2mm me qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe veti të shkëlqyera fiziko kimike, për përdorim të ndryshëm në konstruksione metalike të brendshme dhe të jashtme. Përmasa 40mm x 40mm. Gjatësi 6ml	copë
9	Profile hekuri 60x60x60, 6m	Profile çeliku spesor 2mm me qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe veti të shkëlqyera fiziko kimike, për përdorim të ndryshëm në konstruksione metalike të brendshme dhe të jashtme. Përmasa 60mm x 60mm. Gjatësi 6ml	copë
10	Binarë 10x10	Binarë druri të tharë, seksion 10×10 cm, dru cilësor (bredh, pishë ose ekuivalent), pa deformime, çarje ose nyje të dëmtuara. Të përshtatshëm për konstruksione dhe mbajtje ngarkese. Lagështia ≤20%. Material i trajtuar, i përshtatshëm për ambiente të jashtme	m3
11	Binarë 5x5	Binarë druri të prerë drejt, seksion 5×5 cm, dru i tharë dhe i trajtuar kundër lagështirës dhe insekteve, për përdorime ndërtimore dhe montime të lehta. Material i trajtuar, i përshtatshëm për ambiente të jashtme	m3
12	Dërrasa 5cm trashësi, 15 gjerësi	Dërrasa druri cilësore, trashësi 5 cm dhe gjerësi 15 cm, sipërfaqe e rrafshët, pa deformime, e përshtatshme për ndërtim, konstruksione ose riparime. E trajtuar, e përshtatshme për ambiente të jashtme.	m3
13	Dërrasa 3cm trashësi, 15 gjerësi	Dërrasa druri cilësore, trashësi 3 cm dhe gjerësi 15 cm, e prerë drejt, pa çarje ose dëmtime, për përdorime të përgjithshme ndërtimore dhe zdrukthëtari.	m3

14	Gone'	gone' metalike për lidhjen e trarëve të drurit. Dimensione 8-10 cm	copë
15	Katrama	Katran/katrama bituminoze për hidroizolim dhe mbrojtje kundër lagështirës, me aderencë të lartë në beton, dru ose metal. Rezistente ndaj ujit dhe kushteve atmosferike. 1 top të jetë 10 m <sup>2</sup> .	top
16	Kit kanelle	Kit kanelle me gaz, me bombul 10-15 litra, me rrota për spostim të lehtë.	copë
17	Astar	Astar për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme, bazë akrilike ose sintetike, fuqi e lartë depërtimi dhe ngjitjeje, kohë tharjeje ≤ 6 orë, paketim sipas kërkesës	l
18	Litar (plastik 10 mm)	Litar plastik (polipropilen ose PE), diametër 10 mm, rezistent ndaj lagështirës, tensionit mekanik dhe përdorimit në ambiente të jashtme.	ml
19	Litar lini 40 mm	Litar lini diameter 40mm	ml
20	Litar lini 10 mm	Litar lini diameter 10mm	ml
21	Gozhda të zakonshme 12,10,7,5 cm	Gozhda çeliku të galvanizuara ose të zakonshme për punime druri dhe ndërtimi, me rezistencë të lartë mekanike dhe ndaj korrozionit.	kg
22	Gozhda druri 12,10,7,5 cm	Material hekuri I cilesise se mire	kg
23	Thumba betoni	Material çelik i cilësisë së mirë	kg
24	Elektroda 2 - 2,2 mm	Për bashkimin e elementëve metalikë. Përmasa standarte 2 mm dhe 2.2 mm	kg

25	Punto hekuri 4,6,8,10,12,15	Puntot për shpim metali, të jenë fleksible dhe rezistente ndaj thyerjes. Të përdorshme në pjesën më të madhe të metaleve, jetëgjata dhe precize. Me teh spiral të përforcuar në të gjithë gjatësinë e punës. Me dy thika prerëse cilindrike në majë.	set
26	Punto druri 4,6,8,10,12,15	Puntot për shpim druri, të jenë fleksible dhe rezistente ndaj thyerjes. Të përdorshme në pjesën më të madhe të materialeve drusore, jetëgjata dhe precize. Me teh spiral të përforcuar në të gjithë gjatësinë e punës. Me dy thika prerëse cilindrike në majë.	set
27	Letër zmeril	Për të zmeriluar shtresat e bojës ose sipërfaqeve të tjera metalike me shkëlqim. Përbërje silikon karabit dhe material gërryes që pastrohet shpejt dhe siguron një sipërfaqe të lëmuar. Përdoret për të zmeriluar dhe luçiduar metalet, mobiljet etj. Numra të ndryshëm (200,300,400 etj)	ml
28	Set me leter zmerile me ngjitje dimension 116mm P60	Letër zmerili me ngjitje (Velcro/adhesive), dimension 116 mm, granulim P60 për gërryerje të trashë, për dru, metal dhe sipërfaqe të lyera.	set
29	Set me leter zmerile me ngjitje dimension 116mm P80	Letër zmerili me ngjitje, dimension 116 mm, granulim P80 për përpunim mesatar të sipërfaqeve.	set
30	Set me leter zmerile me ngjitje dimension 116mm P120	Letër zmerili me ngjitje, dimension 116 mm, granulim P120 për lëmime të imët dhe përgatitje para lyerjes.	set
31	Upa+vida 6,8,10	Materiali: Plastik/ metal I galvanizuar	pako

32	Vida me kokë punto për hekur 3,5	Vida vetëshpuese (punto) për metal/hekur, diametër 3.5 mm, material çelik i galvanizuar ose inox, me rezistencë ndaj korrozionit. E përshtatshme për montime metalike dhe llamarine.	pako
33	Vida druri 3,5, 7	Material celik I cilesise se mire	pako
34	Vida betoni 8x7 me up 10	Përdorimi: I përgjithshëm,Materiali: E zinkuar,Mënyra e filetit: Standarte	pako
35	Vida vetshtrënguese me kokë hegzagonale 3,7	Vida vetështrënguese me kokë hegzagonale, diametër 3.7 mm, material çelik i galvanizuar, rezistente ndaj korrozionit dhe konsumit mekanik, për montim në metal ose dru sipas përdorimit.	pako
36	Koka kacavidash të ndryshme	Set kokash kaçavidash (bits) të ndryshme, materiale çelik krom-vanadium (Cr-V) ose ekuivalent, rezistente ndaj konsumit dhe deformimit. Tipe: Phillips, Flat, Torx, Hex, Pozidriv etj.	sete
37	Fasheta plastike të vogla 20 cm x 3.6 mm (100 cope), të zezë	Për të fiksuar kabllot (ose produkte të tjera) që të kenë një paraqitje sa më të rregullt, materiali plastik, dimensione 20 cm x 3.6 mm	pako
38	Fasheta plastike të mesme 30 cm x 3.6 mm (100 cope),të zezë	Për të fiksuar kabllot (ose produkte të tjera) që të kenë një paraqitje sa më të rregullt, materiali plastik, dimensione 30 cm x 3.6 mm	pako
39	Fasheta plastike të mëdha 40 cm x 4,8 mm (100 cope),të zezë	Për të fiksuar kabllot (ose produkte të tjera) që të kenë një paraqitje sa më të rregullt, materiali plastik, dimensione 40 cm x 4,8 mm	pako

40	Dryna 40mm	Dryn metalik, 40mm përdoret për mbylljen e portave, garazheve, magazinave, cantat e veglave etj.përdoret për vrime jo me te vogel se 10mm. Dryni ka 3 celesa. Materiali celik. Me gomina kundra ujit.	copë
41	Dryna 60mm	Dryn metalik, 60mm përdoret për mbylljen e portave, garazheve, magazinave, cantat e veglave etj.përdoret për vrime jo me te vogel se 10mm. Dryni ka 3 celesa.Materiali celik. Me gomina kundra ujit.	copë
42	Fishekë bravash	Cilindër (fishek) për bravë dyersh metalike ose druri, material bronz/tunxh ose çelik, me sistem sigurie dhe çelësa shoqërues. Madhësia sipas tipit të bravës.	copë
43	Shula për dyer	Shul metalik për dyer ose porta, material çelik i galvanizuar ose inox, rezistent ndaj korrozionit dhe përdorimit të vazhdueshëm. Dimension 20 - 26 cm.	copë
44	Mentesha	Material metal i cilësisë së mirë	copë
45	Disqe hekuri të vegjël	Disk për fresibël (për hekur)	copë
46	Disqe hekuri të mëdhenj	Disk për fresibël (për hekur)	copë
47	Disqe betoni të mëdhenj	Disk për fresibël (për beton)	copë
48	Disqe betoni të vegjël	Disk për fresibël (për beton)	copë
49	Disk sharre druri të vogël për fresibël	Disk për fresibël (për drru)	copë

50	Gërshërë krasitëse të mëdha	Gërshërë profesionale për krasitjen e degëve të trasha dhe formësimin e bimëve dekorative. Teh çeliku inox me rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe ndryshkjes. Gjatësi minimale 85 cm, doreza ergonomike dhe sistem amortizues për reduktim force gjatë prerjes..	copë
51	Gërshërë krasitëse të vogla	Gërshërë dore profesionale për krasitje bimësh dhe degësh të vogla. Teh çeliku rezistent ndaj ndryshkjes, prerje precize dhe sistem sigurie bllokues. Gjatësi minimale 20 cm me dorezë ergonomike antirrëshqitëse.	copë
52	Bojë druri	Bojë mbrojtëse dhe dekorative për dru, me bazë sintetike ose alkidike, rezistente ndaj lagështirës, konsumit dhe kushteve atmosferike, për përdorim të brendshëm e të jashtëm. Aplikim me furçë, rul ose pistoletë. Tharje e shpejtë, mbulim i lartë, shkëlqim i lartë, elasticitet maksimal, ngjyra të ndryshme.	1
53	Bojë vaji për metal	Bojë antikorrozive për sipërfaqe metalike, me bazë alkidike/sintetike, rezistente ndaj lagështirës dhe korrozionit. Përdorim për ambiente të brendshme dhe të jashtme. Mbulim i lartë dhe aderencë e mirë mbi metal.	1
54	Bojë hidromat	Bojë akrilike ose plastike për mure të brendshme/jashtme, rezistente ndaj lagështirës, larjes dhe konsumit. Mbulueshmëri e lartë, aplikim me rul/furçë. Ngjyrë sipas kërkesës.	1
55	Hollues	Hollues për bojërat e vajit, cilësi e lartë, shkëlqim të lartë	1

56	Llak me ngjyrë	Llak mbrojtës dekorativ për dru ose metal, me shkëlqim ose gjysmë-shkëlqim, rezistent ndaj lagështirës, UV dhe konsumit mekanik.	l
57	Graso kundra ujit	Graso me aditivë anti-korrozioni dhe antioksidues. rezistente ndaj ujit. e përshtatshme për aplikime në vende që janë në kontakt me ujin.	kg
58	Graso Spray	Graso gjysmë-sintetike, rezistente ndaj presionit të lartë. Lubrifikues me dhunti të shumta të vajit në sajë të vetive të saj të ekuilibruara dhe të harmonizuara. Rezistencë të lartë të ndaj presionit. Ajo formon një shtresë lubrifikuese shumë rezistente ndaj vibrimeve, korrozionit dhe eleminon zhurmat. Nuk i dëmton sipërfaqet e lyera. Rezistente ndaj ujit dhe ujit të kripur, acideve etj. E përshtatshme për lubrifikime universale dhe për pjesë që punojnë në presion të lartë, p.sh. shlica, kuzhinjeta etj. Temperatura e operimit: -25°C deri në +180°C.	copë
59	Silikon ngjitës	Silikon ngjitës universal ose sanitar, rezistent ndaj lagështirës, temperaturave dhe UV. Përdorim për ngjitje dhe izolim në metal, qelq, dru, plastikë dhe sipërfaqe ndërtimore. Paketim standard 280–300 ml.	copë
60	Silikon mbushës	Silikon akrilik mbushës 250 - 300 ml	copë
61	Atak profesional	Ngjitës profesional me aderencë të lartë për materiale të ndryshme (metal, dru, plastikë, gomë, beton etj.), rezistent ndaj lagështirës dhe konsumit. Cilësi industriale/profesionale.	copë

62	Set kacavidash Cr-V	Set kacavidash Cr-V me dorreze me dy komponente me finiteure te zeze e mganetizuar. Dimensionet 5.5x100; 6.5x150; PH1X100; PH2X150; PZ1X100; PZ2X150.	set
63	Komplet celsash fise 4-32	CrV finiteure e kromuar. Dimesnisonet 6x7,8x9,10x11,12x13,14x15,16x17,18x19,20x22,21x23,24x27,25x28,30x32.	set
64	Set celësa kriket 5-27	Set profesional çelësash me mekanizëm kriket, madhësi nga minimumi 5 mm deri 27 mm. Material çelik krom-vanadium i fortifikuar me trajtim kundër korrozionit. Të përfshijë zgjatues, adaptorë dhe kuti mbajtëse rezistente për transport dhe organizim.	set
65	Set kacavidash	Set kacavidash profesionale me madhësi të ndryshme (+/-), material çelik krom-vanadium ose ekuivalent, rezistente ndaj konsumit dhe korrozionit. Doreza ergonomike antirrëshqitëse.	set
66	Komplet celsash hegzagonal	Set profesional çelësash imbus (hex key), me madhësi të ndryshme metrike. Material çelik i fortifikuar me trajtim kundër korrozionit dhe rezistencë të lartë mekanike.	set
67	Komplet celsash Torks	Set profesional çelësash Torx me madhësi të ndryshme. Material çelik i fortifikuar dhe rezistent ndaj konsumit, me organizim praktik në mbajtëse ose kuti.	set
68	Celes kandeles	Çelës profesional për heqje dhe montim kandela motorësh. Madhësi standarde sipas përdorimit të zakonshëm të motorëve me benzinë. Material çelik i fortifikuar rezistent ndaj konsumit.	copë

69	Çekiç	Çekiç pune profesional me kokë çeliku të farkëtuar dhe trajtim termik për rezistencë të lartë. Peshë minimale 500–1000 gr. Me dy dhëmbë funksionalë dhe bisht druri ose fibër rezistente me gjatësi minimum 20 cm, ergonomik dhe antirrëshqitës.	copë
70	Sqepar	Sqepar profesional prej çeliku të farkëtuar dhe të temperuar për prerje druri dhe punime të rënda. Bisht druri ose fibër qelqi me rezistencë të lartë ndaj goditjeve. Teh i mprehur dhe rezistent ndaj konsumit.	copë
71	Këmes	Këmesë për prerjen e degëzave të pemëve. Të jetë material çeliku special dhe me dorezë prej druri të tornuar.	copë
72	Sopatë e zakonshme	Sopatë profesionale prej çeliku të farkëtuar dhe të temperuar për prerje druri dhe punime të rënda. Bisht druri ose fibër qelqi me rezistencë të lartë ndaj goditjeve dhe konsumit.	copë
73	Sharrë dore	Sharrë dore hark me gjatësi 500 mm. me lama të ndërrueshme. Të jetë material çelik cilësor dhe me jetëgjatësi në përdorim.	copë
74	Lama për sharrë dore	Të përshtatshme për sharrë dore 500 mm, material cilësor, për prerje metali.	copë
75	Pinca	Pincë universale profesionale prej çeliku krom-vanadium, me fortësi të lartë dhe rezistencë ndaj konsumit. Doreza ergonomike antirrëshqitëse dhe mekanizëm i përshtatshëm për kapje dhe prerje.	copë

76	Pincë mors	Pincë mors profesionale me sistem automatik ose manual bllokues. Material çelik i fortifikuar rezistent ndaj konsumit dhe deformimit. Madhësi mesatare minimum 200–250 mm.	copë
77	Dara	Darë universale profesionale, çelik i fortifikuar me trajtim kundër korrozionit. E përshtatshme për kapje, prerje dhe shtrëngim. Doreza ergonomike me izolim ose material antirrëshqitës.	copë
78	Meter	Metër me gjatësi 10m x 32mm	copë
79	Sëpatë mishi	Sëpatë profesionale për prerje mishi, me teh prej çeliku inox rezistent ndaj korrozionit. Dorezë ergonomike antirrëshqitëse dhe e përshtatshme për përdorim intensiv.	copë
80	kufje per montim ne kaske	Pajisje mbrojtëse personale për operatorë motor-korrësesh dhe moto-sharrash. Të përfshijë helmetë/skafandër mbrojtëse, mbrojtje dëgjimi (kufje) dhe mbrojtje fytyre me rrjetë ose vizor transparent. Material rezistent ndaj goditjeve dhe përdorimit të zgjatur.	copë
81	Kaske pune	Me rezistence të shkelqyer kundra goditjeve dhe carjeve. Me aftësi absorbuese maksimale. E ndërtuar nga plastike HDPE e dendesise se larte. Standarti: EN397 CE.	copë
82	Filispanje per korrese bari	Fije prerëse profesionale prej najloni me rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe temperaturës gjatë punës. Trashësi minimale Ø 4 mm, e përshtatshme për motor-korrëse bari profesionale. Gjatësi minimale 25 m. Rezistente ndaj këputjes dhe deformimit gjatë përdorimit intensiv.	topa

83	Tel bari	Materiali: Metalik, Ngjyra: Gri,Përmasat: 1.2mm x 2kg Pesha: 2kg,Diametri: 1.2mm	kg
84	Tel xingato 2.7 mm (100 m)	Teli I galvanizuar vjen ne forme te mbledhur me gajtesi 100m dhe trashesi 2.7mm. Ky produkt perdoret gjeresisht ne kopshtet apo vreshtat tuaja per te lidhur apo formuar rrjeta te ndryshme per pemet apo bimet e ndryshme.	topa
85	Guzhineta për karroca	Kushineta (bearing) për karroca transporti, çelik i fortësuar, rezistente ndaj konsumit dhe ngarkesave mekanike, dimension sipas tipologjisë së karrocës.	copë
86	Furça për hidromat	Furçë profesionale për bojëra me bazë uji, fije sintetike cilësore, gjerësi 50–100 mm, dorezë plastike ose druri ergonomike, pa humbje fijesh gjatë përdorimit.	copë
87	Rrula për lyerje hidromat 25-30	Rrul profesional me gjerësi 250–300 mm, material mikrofibër ose poliamid, i përshtatshëm për bojëra hidromat, shpërndarje uniforme e bojës, rezistent ndaj konsumit.	copë
88	Furça për bojë vaji	Fije natyrale ose sintetike të përshtatshme për bojëra vaji, gjerësi 100 mm, dorezë ergonomike, rezistente ndaj tretësve dhe konsumit.	copë
89	Rrula për bojë vaji 10 cm	Gjerësi 100 mm, material i përshtatshëm për bojëra vaji dhe llak, mbulim uniform, rezistencë ndaj tretësve dhe konsumit.	copë
90	Steka për rrul lyerje muri	Material alumin ose çelik i lehtë, teleskopike, gjatësi e rregullueshme 1–3 m, kompatible me rrula standardë lyerjeje, dorezë ergonomike dhe sistem sigurie kundër lëvizjes aksidentale.	copë

91	Doreza pune	Doreza pune profesionale, rezistente ndaj konsumit, prerjeve dhe gërryerjes. Material antirrëshqitës me komoditet të lartë dhe përshtatshmëri për punime mekanike, bujqësore dhe mirëmbajtjeje.	pale
92	Fshesa plastike për pastrim rruge + bisht	Fshesë profesionale për pastrim rruge dhe ambientesh të jashtme, me material plastik rezistent ndaj konsumit dhe kushteve atmosferike. Të pajiset me bisht druri ose metalik rezistent, me gjatësi ergonomike për përdorim praktik.	copë
93	Bela (djathtas) + bisht	Belë për punime toke në formë ovale me punim djathtas. Përmasa minimale 23 x 27 cm dhe peshë rreth 1 kg. Material prej çeliku të temperuar, me rezistencë të lartë mekanike dhe jetëgjatësi. E përshtatshme për punime të ndryshme të tokës. Bisht druri me gjatësi minimale 120 cm, i fortë dhe ergonomik.	copë
94	Shat + bisht	Shat profesional metalik për punime toke, pastrim bari dhe sistemim sipërfaqesh. Material çelik rezistent ndaj konsumit dhe deformimit. Bisht druri me gjatësi të përshtatshme për përdorim ergonomik.	copë
95	Krëhër + bisht	Krëhër për mbledhje bari, gjethesh dhe mbetjesh bimore. Material metalik ose plastik i fortifikuar. Të pajiset me bisht druri ose metalik rezistent me gjatësi ergonomike.	copë
96	Lopatë teknologjike+ bisht	Lopatë ergonomike profesionale për ngarkesa dhe zhvendosje materiali, me dizajn të përforcuar dhe material metalik rezistent ndaj konsumit dhe deformimit. Bisht ergonomik me rezistencë të lartë mekanike.	copë

97	Kosë+ bisht	Kosë profesionale prej çeliku të fortifikuar dhe të temperuar, e përshtatshme për kositje bari dhe bimësie. Me bisht druri rezistent dhe sistem të sigurt fiksimi.	copë
98	Gurë kose	Gur mprehës profesional për kosë, me rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe strukturë të përshtatshme për mprehje efektive të tehut.	copë
99	Kalla për kalitje kose	Enë metalike ose plastike rezistente për mbajtje uji gjatë procesit të mprehjes së kosës. Material rezistent ndaj goditjeve dhe kushteve të jashtme.	copë
100	Capa	Capa dore me dy dhembe ne njerin krah, I lehte ne perdorim , me permasa 24x 5.8 cm.	copë
101	Fshesa për merimanga + bisht zgjatues (3.5-4m)	Fshesë profesionale për pastrim merimangash dhe pluhurash në lartësi. Të pajiset me bisht teleskopik me gjatësi minimale 3.5–4 m, material rezistent dhe peshë të lehtë për përdorim praktik. Kokë pastrimi me fije sintetike rezistente dhe të zëvendësueshme.	copë
102	Fshesa eko konike + bishta	Fshesë konike profesionale për pastrim të ambienteve të jashtme, rrugëve dhe trotuareve. Material sintetik ose plastik rezistent ndaj konsumit dhe kushteve atmosferike. Të pajiset me bisht druri ose metalik të fortifikuar.	copë
103	Furça dore	Furçë dore profesionale me fije sintetike rezistente për pastrim sipërfaqesh të ndryshme. Dorezë ergonomike me kapje të sigurt dhe rezistencë ndaj konsumit.	copë

104	Morsetë për bango	Konstruksion çeliku i rëndë, hapje minimale 100–150 mm, sistem shtrëngimi me vidë, montim në bango pune, rezistencë e lartë mekanike dhe antikorrozive.	copë
105	Çakull	granulometri sipas përdorimit (zakonisht 5–20 mm), i pastër, pa papastërti argjilore ose organike për shtrim rrugicash	m <sup>3</sup>
106	Rërë	Rërë ndërtimi e larë, granulometri uniforme, pa përmbajtje balte dhe materialesh organike, e përshtatshme për llaç dhe beton.	m <sup>3</sup>
107	Çimento	Tipi: CEM II 42.5N për punime ndërtimi dhe riparimi.	thasë/25 kg
108	Gëlqere	Gëlqere ndërtimi e hidratuar, cilësi e lartë, për përgatitje llaçi dhe trajtime ndërtimore.	kg
109	Disqe për korrëse bari me filispanje	Disk metalik prerës për motor-korrëse bari, me diametër minimal 30 cm. Material çelik i fortifikuar dhe i balancuar për prerje efikase të barit dhe bimësisë. Të jetë kompatibël me motor-korrëse profesionale sipas modelit përkatës. Rezistent ndaj konsumit dhe deformimit mekanik.	copë
110	Tronkeza	Çelik i farkëtuar me trajtim antikorroziv, doreza ergonomike të veshura me material antirrëshqitës, gjatësi 180–250 mm, të përshtatshme për prerje teli dhe materiale metalike të holla.	copë

**LOTI I DYTË: Blerje materiale elektrike”**

Nr .	Artikulli	Specifikimet teknike	Njesia	Sasia
1	Kabëll 2*1.5	Kabell ne Izolacion ne HEPR, guajno tipi G7. U <sub>0</sub> /U 0.6/1kV. Sipas stand CEI 20-13-CEI UNEL35318, CEI EN 60332-1-2 Etj. Percjelles fleksibel I klases 5. Guajno e jashteme ne kualitet R16. Kod FG16OR16. Diametri maksimal i fijeve : 1.5mm , Spesori mesatar i izolimit: 0.7mm, Diametri indikativ thelbësor: 10.8mm ,Spesori mesatar të mbështjelljes: 1,8mm Pesha: 180g/m ,Rezistenca elektrike maksimale ne 20 °C: 7.98 ohm/km. Jo perhapes i gazrave helmues.	ml	100
2	Prozhektor 50ë 4000K	Fuqia: 50Ë Lloji i ndriçimit: 3000K Materiali: Alumin Ngjyra: Gri Shkalla e mbrojtjes: IP65 Tensioni: 230 V Për ndriçim të jashtëm	copë	20
3	LED panel	Llampë tavani led panel ,Fuqia: 50Ë Lloji i ndriçimit: 4000K Materiali: Alumin Ngjyra: bardhë Shkalla e mbrojtjes: IP44 Tensioni: 230 V përmasat: 120cmx30cm	copë	10
4	Klemë fundore 4mm	Klemë fundore për kablllo çeliku/tel metalik, dimension 4 mm, material çelik i galvanizuar ose inox, rezistente ndaj korrozionit dhe forcave mekanike, e përshtatshme për fiksime dhe tensionim kablllosh.	copë	200
5	Klemë fundore 6mm	Klemë fundore për kablllo çeliku/tel metalik, dimension 6 mm, material çelik i galvanizuar ose inox, me rezistencë të lartë mekanike dhe ndaj kushteve atmosferike.	copë	200

6	Klemë fundore 8mm	Klemë fundore për kabllo çeliku/tel metalik, dimension 8 mm, material çelik i galvanizuar ose inox, për përdorim industrial dhe të jashtëm.	copë	200
7	Kanalinë plastike me ngjitje 25x25	Kanalinë elektrike PVC me ngjitje vetëngjitëse, dimension 25×25 mm, rezistente ndaj goditjeve dhe temperaturës, me kapak mbyllës, ngjyrë e bardhë ose ekuivalente. Gjatësi standarde 2 m.	ml	50
8	Kanalinë plastike me ngjitje 60mmx15mmx2000m	Kanalinë elektrike PVC me ngjitje vetëngjitëse, dimension 60 mm × 15 mm × 2000 mm, për sistemim dhe mbrojtje kabllorsh elektrike. Rezistente ndaj lagështirës dhe deformimit.	ml	20
9	Izolant	Izolant elektrik, material PVC i pastër, me aprovim CE, ngjyrë e zezë, gjerësi 19mm, trashësi 0.13mm, gjatësi 9.15m.	copë	30
10	Llampa led për spot 6Ë GU 10 4000K	Kapaku: GU10. Fuqia: 6 Ë. Drita: 4000K. Fluksi: 600–750 lm. Tensioni: 220–240 V.	copë	60
11	Zgjatues elektrik 5m	Zgjatues elektrik me gjatësi 5 m me 5 module, kabllo bakri me izolim PVC, minimumi 3×1.5 mm <sup>2</sup> , tension pune 220–240V, i pajisur me mbrojtje sigurie dhe priza standarde europiane.	copë	10
12	Zgjatues korenti me baraban	Zgjatues korrenti me baraban 50 m, 4 M. Dimensionet e fijeve të kabullit 3*1.5 mm H05VV-F. Fuqia 1100 - 3300ë , IP 20, Tensioni 220 - 240 V, numri i moduleve 4, gjatësia e kabullit 50m. Produkti duhet të jetë I brandeve çilesore.	copë	2
13	Darë multimetër HT3010	Multimetër me darë për matje tensioni AC/DC, rrymë, rezistencë, vazhdimësi qarku, ekran LCD, funksion sigurie, ekuivalent ose më i mirë se modeli HT3010	copë	1

14	Set kacavida elektrike	Set kacavidash profesionale të izoluarua për punime elektrike deri në minimum 1000V, të certifikuar sipas standardeve IEC/VDE. Material çelik krom-vanadium ose ekuivalent me rezistencë të lartë mekanike dhe kundër korrozionit. Të përfshijë madhësi të ndryshme (+/-), doreza ergonomike antirreshqitëse dhe izolim rezistent ndaj konsumit.	copë	1
15	Set pinca elektrike	Set pincash profesionale të izoluarua deri në 1000V për përdorim elektrik. Material çelik i fortifikuar krom-vanadium me trajtim kundër ndryshkjes. Seti të përfshijë minimum pincë universale, pincë prerëse dhe pincë me majë. Doreza ergonomike antirreshqitëse, rezistente ndaj konsumit dhe goditjeve mekanike.	copë	2
16	Gërshërë elektrike	Gërshërë profesionale për prerje kabllosh dhe telash elektrikë, me teh çeliku të fortifikuar dhe prerje precize. Doreza të izoluarua deri në minimum 1000V sipas standardeve të sigurisë elektrike. Material rezistent ndaj konsumit dhe korrozionit.	copë	1
17	Indikator me induksion	Testues tensioni pa kontakt (non-contact voltage tester), me sinjal zanor dhe sinjal ndriçues LED. Diapazon minimal matjeje 12–1000V AC ose më i lartë. Të ketë funksion vetë-testimi, mbrojtje ndaj mbingarkesës dhe ndriçim për përdorim në ambiente me ndriçim të ulët.	copë	2
18	Indikator normal	Testues tensioni elektrik me kontakt, për identifikim tensioni në instalime elektrike. Diapazon minimal 100–500V ose më i lartë. Material rezistent ndaj goditjeve dhe izolim sigurie për përdoruesin.	copë	1
19	Multimeter	Rryma: 20 mA – 10 A DC, Tensioni: 200–300 V AC / 200 mV – 300 V DC	copë	1

**LOTI I TRETË: “Blerje materiale hidraulike”**

<b>Nr.</b>	<b>Artikulli</b>	<b>Specifikimet teknike</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Tub uji 1/2-3/4 (zorë)	Tub fleksibël për ujë, material PVC i përforcuar, rezistent ndaj presionit, temperaturës dhe rrezeve UV. Diametër sipas kërkesës: 1/2” dhe 3/4”.	ml	200
2	Tub polietileni 3/4	Tub PE për ujësjellës/ujitje, diametër 3/4”, rezistent ndaj presionit dhe korrozionit, për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm.	ml	100
3	Brryla 3/4	Rakorderi PVC/PE ose metalike 90°, dimension 3/4”, rezistente ndaj presionit dhe korrozionit, për lidhje tubacionesh uji.	copë	20
4	Ti 3/4	Rakorderi tip “T”, dimension 3/4”, material PVC/PE ose metalik, rezistent ndaj presionit dhe lagështirës.	copë	10
5	Xhunto3/4	Bashkues/lidhës për tubacione uji, dimension 3/4”, material rezistent ndaj presionit dhe korrozionit.	copë	10
6	Manikota 3/4	Rakorder lidhës për bashkim tubacionesh, dimension 3/4”, material PVC ose metalik me rezistencë të lartë mekanike.	copë	20

7	Rubinet 3/4	Rubinet metalik (bronzi ose tunxhi i kromuar), dimension 3/4", rezistent ndaj presionit dhe korrozionit, për instalime uji. Pajisur me mekanizëm mbyllës hermetik.	copë	10
8	Gomina për tërheqje uji	Tub fleksibël gome/PVC për tërheqje uji, rezistent ndaj presionit, konsumit mekanik dhe kushteve atmosferike. Diametri sipas kërkesës së përdorimit.	copë	5
9	Pileta Lavamani	Material: inox. Diametri: standart Tipi: me tapë ose pa tapë.	copë	5
10	Sifona Lavamani	Material: PVC Dalja: Ø 32/40 mm Tipi: tub S. Përdorimi: shkarkim ujrash lavamani.	copë	5
11	Tuba fresibël 1/2", 40 cm	Tipi: 1/2" (për furnizim me ujë). Gjatësia: 40 cm. Material: çelik inox i endur + bërthamë gome EPDM. Temperatura: 0–90°C.	copë	10
12	Rezistencë + termostat	Rezistencë elektrike me termostat të integruar ose të veçuar, për ngrohje uji/ambienti sipas përdorimit, tension pune 220–240V, material rezistent ndaj temperaturave të larta dhe korrozionit.	copë	2

13	Çelës hidraulik mesatar	Çelës tubash profesional, i rregullueshëm, i përshtatshëm për punime hidraulike dhe mekanike. Material çelik i farkëtuar me rezistencë të lartë ndaj forcave mekanike dhe konsumit.	copë	1
14	Sprucator për vaditje	Sprucator manual për ujitje me kapacitet minimum 5–10 litra. Material plastik ose metalik rezistent ndaj korrozionit dhe kimikateve bazë. Me pompë manuale funksionale, grykë të rregullueshme dhe rrip mbajtës ergonomik.	copë	10
15	Sarçineska 3”	Sarçineske tunxhi, 2 rondele material PTFE dhe dado celiku, permasa nominale perkatesisht 3” dhe gjatesi sarçineske perkatesisht 61;73;95;113mm, me aprovim MID, CE, TSE, SLM dhe ISO.	copë	5
16	Sarçineska 3/4”	Sarçineske tunxhi, 2 rondele material PTFE dhe dado celiku, permasa nominale perkatesisht 3/4” dhe gjatesi sarçineske perkatesisht 61;73;95;113mm, me aprovim MID, CE, TSE, SLM dhe ISO.	copë	5

17	Bashkues Plastik Ø 40-32	Diameter:40-32 mm,ND:1 1/4"-1",Materiali: polipropileni me rezistencete larte, Temperatura: -100C deri ne +450C,DN 16-630,ISO 15874-3,EN 10226	copë	10
18	Bashkues Plastik Ø 25	Diameter:25 mm,ND:3/4",Materiali: polipropileni me rezistencete larte, Temperatura: -100C deri ne +450C,DN 16-630,ISO 15874-3,EN 10226	copë	10

**Afatet e lëvrimit: 10 dite pune nga nenshkrimi kontrates**

**Vendi; Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik me adrese “ Liqeni i thatë “, Tirane.**

**Shtojca 8.**

**LOTI I PARË:** Objekti i prokurimit: **“Blerje materiale ndërtimore” me Fond limit 3 989 530 ( tre milion e nentëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë ) Lekë pa tvsh**

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
